

Qyteti pa dashuri Sistemi femërvrasës (qytetarvrasës) dhe përshkrimi brilant i tij

Klara Buda, "Kloroform", botoi "Dudaj", Tiranë, 2009

Nëse doni të kuptoni përse në Kosovë nuk ka asnjë monument femrash luftëtare dhe nuk është dhënë asnjë medalje për trimëri, ose nuk është shpallur asnjë heroinë e kombit, e për ta vërejtur sistemin e burrave, që duan gra të virgjra (qoftë edhe duke e qepur himenin) për ta transplantuar moralin, duhet ta lexoni romanin e Klara Budës. Dhe nëse doni të kuptoni se si pleksat një diktaturë që qytetarin e vë në gjumë fillimisht, për t'ia rritur dozën e kloroformit që ai të mos zgjohet më kurrë, lexojeni romanin "Kloroform"

HALA MATOSHI

Autorja me qasjen e saj përshkruar të finesave të diktaturës (që nuk ka moshë, as nuk lokalizohet në hapësirë gjeografike) ka zbërthen kodin e fshehtë sistemit falusian dhe femërvrasës (qytetarvrasës) i cili, e parasheh fundin e botës, pas 3000 vjet.

Për diktatorin dhe refuzimin estetik të saj (jo revolucionar) ka pak literaturë të mirë, por ka shumë tema të mëdha, rrëfime të përmasave epike e me nge, rrëfime fshatareske (ku jeta njëhri ngadalë, tepër ngadalë) si në Makodën e Marquezit, ose si tek romani i tij "Mbi dashurinë dhe demonin të tjerë", por për diktatorin ka pak përshkrimet manash, jo nga thelbi i zjarrtë, ka pak përshkrimet "imtishtë" që përbëjnë pikërisht një botë tjetër, jo rrëfimore, joalkaie as epike, gjithaqsh jo të kalbueshme si përallë, pra një përshkrim urban. Përallë nuk i përket urbisit (në artin amerikan ato cilësohen si legjenda urbane) por votrës, gjakut e trullit. Klara Buda nuk e thotë një përallë me gjumë të koduar artistike, ajo e thotë një përshkrim të hollë të sistemit që e vret mendimin dhe mendësinë (madje edhe përmasat autoensurës) dhe na e jep një pamje tepër brutale të diktaturës, që bluan së pari intimitetin, modelin kulturor, mënyrën urbane të tejetuarit, mendimin refuzues e pastaj edhe mishin e njeriut.

Dhe në këtë rast ngrihet një sistem maskulist, që femrën e vret, për ta ruajtur pamoralin e vet. Buda më parë përfrohet me mënyrën e përshkrimit të pamjes së diktaturës me Herta Mulerin dhe me stilin e durueshëm por të mprehtë të J.Koetzës.

Lajtmotivi i Budës, në romanin "Kloroform" është një grup studentësh, që për t'iu bluarjes së çdo gjëje kanë gjetur azil në një shoqëri të fshehtë, ju do kujtoni se kjo shoqëri ishte e reziqshme dhe komplotiste në të parë, por jo, thjesht kjo "shoqëri sekrete" ishte moshë, brezi i një qyteti që bënte një jetë të dyfishtë, jetën e fshataresisë së komunistizuar dhe atë të urbisit liberal, individualist, shpërfillës ndaj diktaturës, por jo deri në përmasat e një proteste të hapur. Kjo shoqëri që dëgjonte rok and roll dhe debatonte për temat që i përkasin mendësisë së normalitetit e jo kazermës, e cila sa më shumë që barikadohej aq më shumë prodhonte shpërfillje, sepse "shoqëritë sekrete" dëgjonin rok and roll me zemër të sistemitit – në kazermë, kur mbylleshin dritaret me batanije për të mbajtur një ndejë "sekrete" dhe aq të reziqshme kundër sistemit, sepse kishte po "zbutej" dhuna brutale e zërit zyrtar, që emetohej përmes alarmeve me altarpalantë. "Shirti i kasetes me këngë të Bruce Springsteen-it filloi të rrotullohej në kastefon dhe zëri i tij karakteristik bëhej edhe më i gjërë në një My Hometown." (fq.107)

Autorja e pasuron narracionin përmes komenteve që janë refleksione së pari nga dritari i Adrianit (që ben të mundur të jepen me realizëm, jashtë fiksonit, se çfarë mendonin të rinjtë në atë kohë) dhe së dyti, jepen pjesët e mendimit të personazheve që ngelen të pashprehura. Njerëzit kanë frikë dhe vetëcensurohen, kështu që fillojnë të flasin për diçka dhe duke folur kuptojnë se po shkojnë pak larg dhe e ndalin fjalën, nuk e vazhdojnë frazën, fraza ngelet në erë; ky të shprehur "me tej" autorja e jep topografikisht në tekst me shkrim Italiq, si ajo e famshme "stream of consciousness" ose ryma e ndërëgjegjes. Dhe këta njerëz, të rinj, që i lënë frazën


përgjysmë duken sikur janë në një tymnajë, ose si të dehur (nga ku del edhe titulli "Kloroform"), pasi kloroformi në doza të vogla i trullon njerëzit, ndërsa nëse doza rritet, personi bie në gjumë dhe kur doza rritet edhe më, njeriu nuk zgjohet më kurrë. Kështu edhe diktatura i trullon njerëzit dhe pastaj i vë në gjumë (edhe Alma kalon në një dhomë me kloroform ku pasi e vënë në gjumë, i heqin foshnjën pa dëshirën e saj... pastaj përshkruhet skena në mes ndërës dhe realitetit (nën anestezi, në fakt anestezi me kloroform në avuj) apo në një lojë si deliriumi, ku ajo fshikullon moralin e shtirur që dominonte kohën (kur të dashuruarit i këshillonin të praktikonin sodomine për të ruajtur virgëritë, dhe për skandalin askush nuk ka guxuar të fliste as artistikisht), dhe në këtë rast mesazhi është maskuar bukur fort. Por në fakt, komentet vijnë si një lojë makthi i Almës, që njehersh janë situata të demaskimit të moralit fals.

Edhe skena me dy vajzat AB është "konstruktuar" artistikisht për të fshikulluar "shoqëritë e përvetitit të vlerave". Kështu, përpjekja e regjimit për të krijuar njeriun e ri dhe një qenie të përveturuar, sikurse gardianin e morgut, (Marengjen Qani Qeni) i cili realizon edhe kontrapunktin; Pasi ishte një shoqëri që shtuoret (shoqepet), ndërsa Qanua përmes rikonstitimit të himenit kërkon të bëjë të kundërtën, shkon në kahun e kundërt (qepjen).

Por akti më makabër kundër individit (dhe në rastin e romanit të Budës) dhe kundër veriut është edhe vdekja e Luiza Kodrës, malësore shtazënie, e cila kalon direkt (pa ndërhyrje kirurgjikale, për ta shpëtuar nga barra e veshtrë) nga dhoma e saj në sallën e morgut, pasi i inokulojnë në sulucion vdekjeprurës). Pasi "njeriu i ri" (në këtë rast vrasës) Marengjen Qani Qeni, ka marrë përsipër të kryejë abortin e Almës, kundër dëshirës së saj, por siç e do familja e Almës, pjesë e nomenklaturës komuniste. Meqë aborti vetëm në Shoqipëri (dhe në Rumani) nga vendet e lindjes ishte i ndaluar me ligj, ai helmon Luiza Kodrën, për të përdorur identitetin e saj në dokumentet zyrtare, pasi nuk mund të vërë emrin e Almës, sepse nuk ka certifikatë aborti për të...

Kjo është një ngjarje sa e pabesueshme, aq edhe tragjike. Qanui la imponon Almës identitetin e malësore Luiza Kodra që do të vdesë (vritet) për të shërbyer si identitet i rremë për Almën... Krimi i parë ishte loja, mbikëqyrja e saj, kur parulla "ju me ju me popullin" e kishte kodin e fshehtë që do të thoshte mos e lini popullin vetëm, shoqërojeni deri në var, përgjojëni, bëjeni pronë të partisë. Dikur ndalohej qeshja, sepse po u zure duke u ngërdeheshur qoftë edhe krejt pa shëry, vetëm se të hapet goja ashtu instinktivisht, dënoshesh me heqje lirie qytetare. Pastaj gjuha, këputja e krahëve të shqipes, (edhe gënjishta shndërron në rezistencë vetëveta. Autorja përmes veriorit Fran thotë se "veriu i përjashtuar trup e shpirt!"; e bë vendin më të vogël (edhe fizikisht) pra edhe më lehtë të kontrollueshëm. Dhe një veriore vritet vetëm se një familjeje nga nomenklatura i duhet një dokument fals për abortin e vajzës së tyre.

Pastaj art, "asgjësimi i pushtetit të artit" duke ua kthyer artin masave e duke ua marrë atë artistëve të vërtetë, përmes doktrinës zyrtare të realsocializmit, vetë sistemi prandaj kujdeset që të fabrikohet duartroktija, që krijojnë parakushtet për masivizimin dhe "fshatarëzimin" e tij si vrasje shpirtërore dhe në fund synohet bluarja e mishit



Klara Buda
Kloroform

të njeriut femër. Heqja me dekrete e barrës (fryt) dhe pastaj qepja e himenit për qëllime të moralit amoral të diktaturës, që të prodhonte sa më shumë virgëri artificiale dhe sa më shumë viktime të dhunës. Personazhi i Budës, Alma Fishta (zgjedhja e mbiermit nuk është rastësi, por vjen si opozicion personalifikues ndaj diktaturës) tek pas viktimitimit (vrasjes së dyfishtë, shpirtërore dhe të fryt) e ndien (ose e mëson) leksionin nga gra mosprerilëse ndaj sistemit, vetëm pse ishin të etnisë së nëpërkëmbur, asaj rome, por edhe në aspektin social, qytetarë të rendit të dytë në komb dhe shtet, pastuese rruqësh, sipas të cilit leksion "mëmësisë është realiteti i vetëm që i shpëton diktaturës."

Në fillimet e krijimit të njeriut të ri, sistemi kishte instaluar transplantimin e himenit, për ta ruajtur nderin si pompë të propagandës zyrtare, që do të thotë sistemi po e bente transplantimin e nderit. "E imagjinon kryetartikulin e 'Zërit të Popullit'? Vendi i parë në Evropë që transplanton nderin. Një nder i ri fringo!" (fq. 94) Dhe kjo "shoqëri sekrete" më në fund do të bluhej, si çdo gjë e gjallë në diktaturë, jo se ka bërë ndonjë krim, por pikërisht se i ka qëndruar anash krimin. Ndoshta faji i vetëm i të cilit është se ka aspiruar pak më tepër liri dhe intimitet. Ngase sistemi ishte shndërruar në panoptikon ku "vëllai i madh" ju sheh.

Pra, sistemi, intimitetin njerëzoret e ka shndërruar në lajm kombëtar, në radion shtetërore... Alma Fishta është qytetaria që pa kurrfarë mandati të shkruar vendoset në gjendje arresti në spitalin gjinekologji-obstetrik, ku ishin edhe fillestat e shpërfilljes së regjimit; ku papandehur në orën tre e gjysmë para mëngjesit, në kohën e gjumit paradoksal, mund të hyjë policia sekrete: "Qytetare mos bëni asnjë lëvizje! Në emër të Popullit, jeni e arrestuar!" (fq. 173) dhe merreni me mend, arresti vjen pikërisht në emër të popullit, kur ai flet gjumun paradoksal!

Për fund po e dijoj një koment, brilant, i kodifikuar dhe tepër i veçantë, për diktaturën shqiptare të Alma Fishtës: "Një shoqëri që qeveriset nga një teori e veçantë relativiteti, si një tren me shpejtësi të mërguar, më të vogël se zeroja. Një tren me shpejtësi negative, një relativitet i llojit shqiptar!" (fq. 173) si një koment për sot dhe këtu, derisa po shkruaj këto radhë. Shikoj për dritare në sheshin e një qyteti kazermë, në sheshin e një palo-qryqyqyzi të sëmurë, ku gjatë natës, nga shpura të spjuanzhit partiak rruqësh shënohen me emrat e qytetarëve shembullor, të cilët sistemi aktual i ka damkosur si "armiqt të shtetit!"; (sepse diktatura nuk mund të mbijetojë pa armiq) e të cilëve u dërgon mesazh se mund të vriten si arkitekti, emrin e të cilit e mban ajo rruqë. Eçje pa cak, agresion e propagandë përjashtuese ndaj tjerit/tjetrës, ku gjuha e shqipes është shkurtuar, ku qeshja është ndaluar, sepse konceptohet si shpërfillje madje dhe tallje ndaj një pushteti fshataresk e autokratik, ku edhe arti dhe kultura janë fshatarizuar.

Fshatarizimi në këtë nuk ka konotacion gjeografik por mental. Ky vend është sindromë e trenit me shpejtësi negative, që ec prapthi si në romanin e Klara Budës.

Në Prishtinë, më 14 maj, 2010

Urban Painting Prishtina në art

Për ekspozitën personale të Dita Ethmit, "Urban Painting", që është mbajtur në galerinë "Klovicevi Dvori" në Zagreb, në prill 2010

STANISLAV ŠPOLJARIĆ

Indi i qytetit, shpërndarja e grumbujve urban të tij në strukturën e pikturës së Dita Ethmit është batur përmes heqjes dorë nga të përshkruarit joshës të gazmores.

Duke u nisur nga hapësira vetjake e Prishtinës së përvetësuar, qytetit të rritjes së shpejtë, lidhjes së pamjeve të trashëguara me ato të reja, ambientet e ndërtaura sipas parimeve të urbanizmit modern. Zgjerimi i qytetit, deri diku pakontrollueshëm krijon vizura të reja, situata të rrejta me zhvillimin dinamik tek qytetet e tjera metropolitane. Prishtina është shkasi i drejtëpërdrejtë i pikaturave të Ditas, me vulën e veçantë të karaktereve "portreteve" të qytetëve të tjera. Shembulli konkret ka marrë shenjë të përgjithshme, kështu që veçantitë e hapësirës janë gërshetuar në logjikën autonome të pikturës. Dita Ethmi me sensibilizimin e një artisteje të re e ka ndër puslimin e përbërësve të qytetit dhe përmes lidhjes së abstraktiveve gjeometrike dhe protezave të gjeosteve ekspresioniste e ka menduar sipërfaqen e vëprës.

Në kompozicionet kryesisht vertikale, Dita përmes shiritave të shyer, të lexueshëm dhe të qartë krijon tensionin e lëndës, të potencuar me fuqitë e kloritit. Ritmi i segmenteve, madhësitë e tyre të ndërrueshme piktorialisht është shprehje kreative e gjendjeve urbane, në ndërrim për rregullin e rendit dhe fragmenteve të vendosura lirshëm.

Piktura e Ditas lidh sistemin e qartë të koordinatave dhe me imaginatën zhvillon të gjitha travetit e formës.

Me zgjidhje përmes "gigantizmit" vetëm disa fusha relativisht të ngushtuara të paletës, pothuajse tonalitetit të spastruar, deri të hapja koloristike të lëndëveve në partikula të shumta në shpërshfaqjen e skenës urbane. Dita është e preokupuar me teksturën e sipërfaqes, si tek njësitë e shfaqura me kujdes ashtu edhe tek partitë e goditjes së lirë, në kultivimin e ngjyrës dhe ruajtjes së thelbit kromatik.

Shpërndarja konstruktive mbledh të gjitha pjesëzat e hapësirës së qytetit të sjellë në sipikamë, duke e lënë mundësinë e thellësisë së sugjeruar.

Si me energji ngjyre ashtu edhe me kombinatorikën e ndërthurur të vija të rregullta të trashura, Dita Ethmi me freski të padiskutueshme piktorale harmonizon pikturën e rendit, duke e baraspeshuar pasimin e formave të parashikueshme dhe i drejton në strukturën e kompozicionit, duke u dhënë masën e notave rationale të së papriturës. Sharmi i lojës piktorave ndihet edhe në krijimin e kufirit ekzakt, së pari përmes shkëndjave të ngjyrës në shkëlqimin e dritës.

Në paletë rikrijohet ikonografia e hapësirës urbane, shenja e re e vitalitetit të qytetit. Drita është esenciale, e jo vetëm element formal i pikturës, por e pavarësuar në trupat e ngjeshur e të zgjatuar, të afëruar prejkes.

Me vlerat e spektrit të proporcionit, drita si simbol i qytetit bashkëkohor, Dita Ethmi artistikisht përmes organizimit të lexueshëm ka imagjinuar tablionë, duke marrë parasysh edhe difuzitetin e dritës, në sintezën e vërtetësisë dhe të fluidës.

